

Dt. 17.10.2017.

Shtojcë për modifikim dokumentacioni, Dokumentat Standarte të Tenderit dhe për shtyrjen e afatit të hapjes së ofertave në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: "Furnizim Vendorsje me makineri e pajisje mekanike e të tjera i ambienteve / godinave të Tirana Olimpik Park"

Të nderuar operatorë ekonomikë!

Njësia e Prokurimit pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë, ka konstatuar se në Dokumentat Standarte të Tenderit për procedurën me objekt: **"Furnizim Vendorsje me makineri e pajisje mekanike e të tjera i ambienteve / godinave të Tirana Olimpik Park"** është bërë një lapsus si më poshte:

Në **KRITERET E VECANTA TË KUALIFIKIMIT/ Kapaciteti teknik: pika 7 ku konkretisht është shprehur se:**

7. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda të cilet duhet të jenë automakiniste .Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.

Si dhe

Në **KRITERET E VECANTA TË KUALIFIKIMIT/ Kapaciteti teknik: pika 2, Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:**

- a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

N.P – 10 A (Ndërtime i impianteve per prodhimin e energjise elektrike)

Ne proceduren e prokurimit me objekt **"Furnizim Vendorsje me makineri e pajisje mekanike e të tjera i ambienteve / godinave të Tirana Olimpik Park"** këto kritere **ndryshojnë sa më poshtë:**

1. Pika 7, ku kërkohen **2 (dy) punonjës manovratorë** të mjeteve të rënda të cilet duhet të jenë Automakinistë, **Hiqet.**
2. Pika 2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, pika **N.P – 10 A (Ndërtimi i impianteve per prodhimin e energjisë elektrike), Hiqet.**

Referuar sa më sipër, Njësia e Prokurimit e cila administron të gjithë procesin e prokurimit vendosi në mbështetje të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 për "Prokurimin publik" i ndryshuar, Kreu V, neni 42 pika 2 dhe 2.1, të zgjasë afatin kohor të hapjes së ofertave.

Nisur nga sa më sipër sqarojmë se Hapja e ofertave **do të jetë** si më poshtë vijon:

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 13.11.2017 Ora: 11:00

Vendi: www.app.gov.al , Bashkia e Tiranës , Tiranë

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 13.11.2017 Ora: 11:00

Vendi: www.app.gov.al , Bashkia e Tiranës , Tiranë

